



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr. 08-213
8.8.2025
Shkup

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 2 dhe neni 20 paragrafi 1 nënparagrafët 10¹ dhe 13, dhe në lidhje me nenin 71 paragrafi 1 nënparagrafët 17 dhe 18 dhe neni 75 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e RMV-së“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 2, neni 39 paragrafi (1) nënparagrafët 10 dhe 13 dhe neni 51 paragrafi (1) të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.7.2019, pas zbatimit të Konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimi programor në nivel lokal të publikuar në bazë të Vendimit të Agjencisë për shpallje të konkursit publik, PA1 nr.08-153 datë 8.5.2025 („Gazeta Zyrtare e RMV-së“, nr.96/25 datë 14.5.2025), në pajtim me Raportin për vlerësim të aplikimit të paraqitur PA1 nr.08-213 datë 4.8.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3325/3 datë 7.8.2025, në seancën e 7-të mbajtur më 7.8.2025 miratoi sa vijon:

VENDIM

**për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimi programor,
në nivel lokal, në zonën e komunës së Strugës**

1. I NDAHET leja për transmetim në radio të shërbimit programor radio folëse – muzikore me format të përgjithshëm kryesisht informativ në gjuhën shqipe dhe maqedonase, në nivel lokal, në zonën e komunës së Strugës, kandidatit, personit fizik Ensar Alushi nga Struga, me adresë banimi në Misleshefski pat p.n, Strugë.

Shërbimi programor në radio nga paragrafi (1) të kësaj pike do të transmetohet nëpërmjet radiofrekuene të përcaktuar nga Agjencia për Komunikime Elektronike të Republikës së Maqedonisë së Veriut (AKE), përkatësisht: 104.2 MHz.

2. Leja për transmetim në radio në nivel lokal, e cituar në pikën 1. të këtij Vendimi, jepet për një periudhë kohore prej 9 (nëntë) vitesh dhe nuk mund t'i transferohet një personi tjetër.

3. Pas pranimit të këtij Vendimi për dhënien e lejes, kandidatit në konkurs, personi fizik Ensar Alushi nga Struga, të cilit i është dhënë leja nga pika 1. të këtij Vendimi, duhet të regjistrojë një Shoqëri Tregtare Radiodifuzive në regjistrin përkatës, në pajtim me nenin 77 paragrafët (1) dhe (2) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV).

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive, e cila do të themelohet nga kandidati në konkurs, personi fizik Ensar Alushi nga Struga, të cilit i është dhënë leja nga pika 1. të këtij Vendimi, do të paguajë kompensim vjetor për leje në llogarinë e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia), për çdo vit aktual duke filluar nga data e dhënies së lejes

¹ Nënparagrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.248/18).

në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të faturës së lëshuar nga Agjencia. Mënyra e llogaritjes, faturimit dhe pagesës së kompensimit për leje përcaktohet nga Agjencia në pajtim me nenin 80 të LSHMAAV dhe në pajtim me Rregulloren mbi procedurat e punës financiare dhe kontabël të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e RM-së“, nr.185/14), Rregulloren për formatet e shërbimeve programore të transmetuesve („Gazeta Zyrtare e RM-së“, nr.172/14) dhe Rregulloren për zonat e transmetimit të programeve televizive dhe radio („Gazeta Zyrtare e RM-së“, nr.172/14).

4. AKE në bazë të lejes për transmetim në radio për shfrytëzim të radiofrekuencave jep miratim për shfrytëzim të radiofrekuencave në pajtim me Ligjin për Komunikime Elektronike.

Për shfrytëzim të radiofrekuencave, paguhet kompensim vjetor në llogari të AKE për çdo vit aktual paraprakisht duke filluar nga data e vlefshmërisë së miratimit për shfrytëzim të radiofrekuencave.

5. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive, e cila do të themelohet nga kandidati në konkurs, personi fizik Ensar Alushi nga Struga, të cilit i është dhënë leja nga pika 1. të këtij Vendimi, detyrohet të fillojë me kryejën e veprimtarisë me datë 10.9.2025.

Në rast të mosrespektimit të afatit për fillimin e kryerjes së veprimtarisë cituar në paragrafin (1) të kësaj pike të Vendimit, Agjencia do ta marrë lejen e dhënë para skadimit të afatit për të cilën është dhënë leja dhe do të fshijë transmetuesin nga regjistri i transmetuesve.

6. Personi fizik, cituar në pikën 1 të këtij Vendimi, të cilit i është dhënë leja për transmetim në radio, është i detyruar plotësisht të përmbushë kushtet dhe kërkesat për të cilat është obliguar në Aplikim gjatë konkurrit.

Agjencia do të kryejë mbikëqyrje profesionale në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga skadimi i ditës së tridhjetë nga dita e fillimit me kryerje të veprimtarisë të përcaktuar në lejen për transmetim në radio, me qëllim përcaktimin e përmbushjes së kushteve teknike, në pajtim me lejen për transmetim në radio.

7. Për këtë Vendim me shkrim të njoftohet kandidati në konkursin publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Strugës, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e miratimit të vendimit.

8. Ky Vendim është përfundimtar dhe publikohet në „Gazetën Zyrtare të RMV-së“ dhe në ueb faqe të Agjencisë.

A r s y e t i m

Në pajtim me nenin 69 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), për shërbimin programor të radios teristrale që transmetohet nëpërmjet resursi(burimi) të kufizua siç janë radiofrekuencat, Agjencia jep leje për transmetim në radio nëpërmjet konkursi publik.

Agjencia në pajtim me nenin 70 paragrafi (1) të LSHMAAV, miraton vendim për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio, sipas detyrës zyrtare ose me pranim të kërkesës me shkrim nga pala e interesuar, në pajtim me Planin për ndarjen dhe shfrytëzimin e radiofrekuencave si dhe në pajtim me Studimin, mënyrën dhe procedurën e përcaktuar në nenin 70 të Ligjit të lartpërmendur.

Këshilli i Agjencisë miratoi Vendim për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Strugës, PA1 nr.08-153 datë 8.5.2025 („Gazeta Zyrtare e RMV-së“, nr.96/25 datë 14.5.2025), në bazë të Kërkesës për dhënien e lejes për transmetim në radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Strugës nga palë e interesuar, personi fizik Ensar Alushi nga Struga (ark.nr.08-432/1 datë 29.1.2025), Njoftimi i paraqitur nga AKE në lidhje me kërkesën për informacion për frekuenca të lira për transmetim të programit në radio në zonën e komunës së Strugës, ark.nr.0805-376/2 datë 12.2.2025 (nr.ynë ark.08-432/3 datë 24.2.2025), a dhe në pajtim me Studimin e përgatitur

për përcaktimin e arsytimit për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Strugës (ark.nr.03-1927/1 datë 29.4.2025).

Afat i fundit për dorëzimin e aplikimeve për pjesëmarrje në konkursin publik në fjalë ishte deri më 14.7.2025, përkatësisht kandidatët në konkurs duhej të dorëzonin aplikim në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh, duke llogaritur nga dita e parë pas ditës së publikimit të vendimit në „Gazetën Zyrtare të RMV-së“. Deri me datë 14.7.2025 (si afat i fundit për dorëzimin e aplikimeve), drejtua Agjencisë ishte dorëzuar 1 (një) Aplikim me dokumentacion shoqërues për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Strugës me datë 14.7.2025, nga kandidati, personi fizik Ensar Alushi nga Struga (PA1 nr.08-213).

Hapja publike e Aplikimit të dorëzuar për pjesëmarrje në konkursin publik nga kandidati i lartpërmendur, u mbajt 1 (një) javë pas skadimit të afatit për paraqitjen e aplikimeve, përkatësisht me datë 22.7.2025, me ç'rast aplikim i paraqitur u shqyrtua nga aspekti nëse është i rregullt, në kohë dhe i plotë, përkatësisht nëse i përmban të gjitha dokumentet e përcaktuara në nenin 73 paragrafi (3) të LSHMAAV, të cilat i referohen kandidatit – personit fizik, për të cilin është mbajtur Procesverbal i hapjes publike (PA1 nr.08-213 datë 22.7.2025)

Në periudhën nga data 23.7.2025 deri më 29.7.2025, nga sektorët kompetentë të Agjencisë është vazhduar me vlerësimin e Aplikimit sipas konkursit publik në fjalë (PA1 nr.08-213 datë 14.7.2025) paraqitur nga kandidati, personi fizik Ensar Alushi nga Struga. Aplikimi i dorëzuar në afatin e përcaktuar u vlerësua nga sektorët kompetentë të Agjencisë, sipas kriterëve të vlerësimit përcaktuar në tabelën në pikën 5 të Vendimit PA1 nr.08-153 datë 8.5.2025 për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal. Sektori për çështje programore vlerësoi kriteret nga pika 1, pika 2, pika 3, pika 4 dhe pika 7 të tabelës; Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit vlerësoi kriterin nga pika 5 e tabelës; Sektori për financa dhe logjistikë vlerësoi kriterin nga pika 9 e tabelës dhe Sektori për mbështetje informative dhe çështje të përgjithshme vlerësoi kriterin nga pika 6, pika 8 dhe pika 10 të tabelës, nga ku është konstatuar se Aplikimi PA1 nr.08-213 datë 14.7.2025, nga kandidati, personi fizik Ensar Alushi nga Struga është i rregullt dhe u vazhdua me vlerësimin dhe pikëzimin e tij.

Kështu që, Sektori për çështje programore (SÇP) në kontributin e dorëzuar më 29.7.2025, ka konstatuar se Aplikimi i kandidatit – personit fizik Ensar Alushi nga Struga është i rregullt nga aspekti programor, përkatësisht janë dorëzuar të tre dokumentet nga aspekti programor. Sipas të dhënave të dorëzuara, radioja i përmbush kushtet programore të Dokumentacionit të konkursit për radio folëse – muzikore me format të përgjithshëm kryesisht informativ që do të transmetojë program në gjuhën shqipe dhe maqedonase. Rregullorja për formatet e shërbimeve programor të transmetuesve përcakton se tek radio folëse-muzikore, përmbajtjet folëse duhet të përfaqësojnë mbi 15% deri në 25% të totalit të programit të transmetuar gjatë javës, ndërsa në Konceptin programor të dorëzuar është cituar se pjesa folëse do të përbëjë 15,6% nga totali i programit të transmetuar gjatë javës. Gjithashtu në pajtim me Rregulloren, të radios folëse – muzikore ku përmbajtjet folëse të programit përmbushin kryesisht një funksion mediatik, ajo nuk duhet të përfaqësohet me më pak se 50%, as edhe më shumë se 65% në total të programit të transmetuar gjatë një jave, ndërsa në Konceptin programor të kandidatit, programet me funksion informativ do të përfaqësohen me 56.48% në total të programit të transmetuar. Gjithashtu, siaps të dhënave, programit dhe disa pjesë të muzikës do të transmetohen në gjuhën shqipe dhe maqedonase. SÇP ka konstatuar se ekziston mospajtim të të dhënave nga Koncepti programor dhe nga Skema programore, por ato nuk ndikojnë në përmbushjen e kushteve programore nga Dokumentacioni i konkursit, sepse sipas çdo lloji llogaritje të të dhënave, në bazë të Konceptit programor ose në bazë të Skemës programore, radio do t'i përmbushë kushtet programore të Dokumentacionit të Konkursit dhe prandaj është vazhduar me pikëzim të Aplikimit. Përndryshe, në rrethana kur leja nuk jepet me konkurs, zakonisht nga parashtuesi kërkohet që të harmonizojë të dhënat në Konceptin programor dhe Skemën e programit. SÇP vazhdoi me pikëzimin e mëtejshëm, përkatësisht: pika 1 e tabelës – Përfaqësimi i programi të prodhuar nga vetë transmetuesi (in-house production) gjatë javës, si shpjegim për përmbushjen e këtij kriteri deklaroi se sipas të dhënave të dorëzuara 99.20% e pjesës folëse të programit gjatë javës do të prodhohet nga vetë transmetuesi; pika 2 e tabelës – Cilësia, zhanri dhe diversiteti tematik i përmbajtjeve, si shpjegim për përmbushjen e këtij kriteri deklaroi se radio planifikon mbi 5 lloje programesh në pjesën folëse të programit ose më saktë 9 lloje programesh që përmbushin të tre funksionet

mediatike; pika 3 e tabelës – Përfaqësimi i programeve që nxisin zhvillim dhe ruajtjen e kulturës kombëtare, si shpjegim për përmbushjen e këtij kriteri deklaroi se radio planifikon të transmetojë 16 orë program në nivel vjetor që do të nxisë zhvillim dhe ruajtjen e kulturës kombëtare. Gjithashtu, është planifikuar që 50% në total të muzikës së transmetuar gjatë ditës të jetë muzikë instrumentale nga autorë maqedonas, muzikë vokale dhe/ose instrumentale në gjuhën shqipe dhe meqedonase; pika 4 e tabelës – Përfaqësimi i informacionit dhe përmbajtjes në pjesë folëse të programit me rëndësi për zonën në të cilën do të transmetohet shërbimi programor (informacion me karakter lokal), gjatë javës, si shpjegim për këtë ka cituar se gjatë javës, në pjesën folëse të programit, është parashikuar të transmetohet në total 6 orë 13 minuta dhe 50 sekonda informacion dhe përmbajtje me rëndësi për zonën në të cilën do të transmetohet shërbimi programor (informacion me karakter lokal), me funksion informativ dhe edukativ dhe pika 7 e tabelës – Koha e ofruar e transmetimit ditor të programit, si shpjegim për përmbushjen e kriterit është cituar se radioja planifikon të transmeton 24 orë program ditor.

Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit (SPSDA), në kontributin e paraqitur më 29.7.2025, ka konstatuar se kandidati – personi fizik Ensar Alushi nga Struga i plotëson kushtet minimale kadrovike nga pika 5 e tabelës – Numri dhe struktura e punonjësve të nevojshëm për kryerjen e veprimtarisë, përkatësisht e plotëson kriterin të ketë së paku dy persona pjesëmarrës në krijimin e programit, të punësuar tek transmetuesi me kohë të plotë pune, në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune dhe redaktori përgjegjës i shërbimit programor të jetë në marrëdhënie të rregullt pune. Gjatë evaluimit të Aplikimit, SPSDA ka konstatuar në pajtim me Formularin nr.4 – Numri dhe struktura e punonjësve të nevojshëm për kryerjen e veprimtarisë, tek transmetuesi do të angazhohen 2 (dy) persona në marrëdhënie të rregullt pune dhe me kohë të plotë pune. Në Planin e punës është theksuar se në marrëdhënie të rregullt pune do të jetë redaktori përgjegjës i shërbimit programor që njëkohësisht është dhe gazetar dhe një operator-teknik. Nga aspekti i kufizimit të fitimit të pronësisë dhe koncentrim të paligjshëm mediatik SPSDA ka konstatuar se nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e lejes. Parashtruesi i aplikimit, personi Ensar Alushi figuron (paraqitet) si person i autorizuar i Shoqatës për Kulturë dhe Integrim të Rinjve “AVANGARD KULTURA” Strugë (personi juridik nuk figuron si themelues i shoqërive tregtare). Ensar Alushi gjithashtu figuron si themelues dhe drejtues i Shoqërisë së Telekomunikacionit dhe Radiodifuzionit “RADIO STRUGA” SHPKNJP Strugë, themeluar në regjistrin Qendror të RMV-së me datë 30.6.2025, përkatësisht pas miratimit të Vendimit për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes. Veprimtari prioritarë/shifra kryesore e të ardhurave të këtij personi juridik është 60.100 – Veprimtari për transmetim të radioprogramit dhe distribuim të përmbajtjeve audio, por nuk kemi të bëjmë me transmetues sepse nuk ka leje dhe nuk transmeton program në radio (dhe ky person juridik nuk figuron si themelues të shoqërive tregtare).

Sektori për financa dhe logjistikë (SFL) në kontributin e dorëzuar më 23.7.2025, ka konstatuar se dokumentet e paraqitura nga personi fizik Ensar Alushi për konkursin për radio lokale për zonën e komunës së Strugës në lidhje me aspektin financiar janë të kompletuara. Si shpjegim për përmbushjen e kriterit nga pika 9 e tabelës – Garancitë e ofruara për gjendjen financiare për realizimin e veprimtarisë, nga SFL është cituar se kandidati ka dorëzuar plan biznesi që përmban dhe planin financiar të parashikuar të radios për 3 (tre) vitet e ardhshme, si dhe si garanci të ofruara për aftësinë financiare për realizimin e veprimtarisë kandidati ka vërtetim nga banka komerciale për depozit në denarë në pronësi të tij dhe për gjendjen e llogarisë së tij në denarë, nga ku SFL vazhdon me pikëzimin e mëtejshëm të aplikimit.

Sektori për mbështetkje informative dhe çështje të përgjithëshme (SMIÇP) në kontributin e dorëzuar më 28.7.2025, ka konstatuar se Aplikimi i kandidatit – personi fizik Ensar Alushi nga Struga është i rregullt dhe vazhdoi me pikëzimin e mëtejshëm, përkatësisht: pika 6 e tabelës – Kushtet teknike për prodhimin e programeve, në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri, nga (SMIÇP) është konstatuar se në pajtim me Formularin nr.2 ku plotësohen kushtet teknike për prodhimin e programit, kandidati ka përmbushur kushtet e kërkuara të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio; pika 8 e tabelës – Kushtet hapësinore për kryerjen e veprimtarisë, në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri nga (SMIÇP) është konstatuar se në pajtim me Formularin nr.2 ku janë paraqitur dhe kushtet hapësinore për kryerjen e veprimtarisë, kandidati ka përmbushur kushtet e kërkuara në pajtim me Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio dhe pika 10 e tabelës – Afati i ofruar për fillimin e kryerjes së veprimtarisë, në lidhje me

plotësimin e këtij kriteri nga (SMIÇP) është konstatuar se kandidati në aplikim si afat për fillimin me kryerje të veprimtarisë ka vendosur datën 10.9.2025, që do të thotë deri në 3 (tre) muaj nga dita e dhënies së lejes.

Në bazë të vlerësimit të përfunduar dhe pikëzimit të Aplikimit për pjesëmarrje në konkursin publik të kandidatit, personit fizik Ensar Alushi nga Struga, numri i përgjithshëm i pikëve të ndara është 98 pikë, siç është përcaktuar në Raportin e vlerësimit të aplikimit të përgatitur nga Agjencia PA1 nr.08-213 datë 4.8.2025 dhe është konstatuar se Aplikimi PA1 nr.08-213 datë 14.7.2025, paraqitur nga kandidati i vetëm, personi fizik Enas Alushi nga Struga, i përmbush kushtet e përcaktuara në konkursin publik në pajtim me Vendimin e Agjencisë për shpalljen e konkursit publik, PA1 nr.08-153 datë 8.5.2025 („Gazeta Zyrtare e RMV-së“, nr.96/25 datë 14.5.2025).

Me qëllim që të vërtetohen në mënyrë të drejtë faktet gjatë marrjes së vendimit për dhënien e lejes për transmetim në radio, të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Strugës, përkatësisht të përcaktohet se në cilat shoqëri tregtare paraqitet si themelues/pronar ose udhëheqës personi fizik Enas Alushi nga Struga, Agjencia me datë 23.7.2025 dhe më 28.7.2025, nëpërmjet sistemit të Shpërndarjes së internetit të Regjistrat Qendror të RMV-së, siguroi „Informacion për statusin e subjektit (personat autorizuar, organe drejtuese, pronarë në subjekte të tjera – gjendja vijuese“, nr.0820-50/150020250279488 datë 23.7.2025, nr.0820-50/150020250284616 datë 28.7.2025 dhe nr.0820-50/150020250284628 datë 28.7.2025, „Gjendja vijuese“ nr.0805-50/150020250279540 datë 23.7.2025 si dhe „Gjendja vijuese për personin fizik – pronar i vërtetë“ nr.2007-50/150020250284635 datë 28.7.2025, ku është konstatuar se nuk shkelen dispozitat e Kapitullit IV të LSHMAAV.

Në lidhje me Raportin nga vlerësimi i aplikimit të paraqitur për pjesëmarrje në konkursin publik për dhënien e lejes për transmetim në radio në nivel lokal PA1 nr.08-213 datë 4.8.2025, personi i autorizuar nga drejtori i Agjencisë, drejtuar Këshillit të Agjencisë dorëzoi Propozimin PA1 nr.08-213 datë 6.8.2025, për miratimin e vendimit për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor, në nivel lokal, në zonën e komunës së Strugës, kandidatit, personit fizik Ensar Alushi nga Struga, me adresë banimi në Misleshevski pat p.n, Strugë.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, Këshilli i Agjencisë në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 2 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 10 dhe 13, dhe në lidhje me nenin 71 paragrafi (1) nënparagrafët 17 dhe 18 dhe neni 75 të LSHMAAV, neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 2, neni 39 paragrafi (1) nënparagrafët 10 dhe 13 dhe neni 51 paragrafi (1) të Rregullores së Punës së Agjencisë (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.7.2019, pas zbatimit të konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, publikuar në bazë të Vendimit të Agjencisë për shpallje të konkursit publik, PA1 nr.08-153 datë 8.5.2025 („Gazeta Zyrtare e RMV-së“, nr.96/25 datë 14.5.2025), në pajtim me Raportin e vlerësimit të aplikimit të paraqitur PA1 nr.08-213 datë 4.8.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3325/3 datë 7.8.2025, në seancën e 7-të mbajtur më 7.8.2025, miratoi Vendim si në dispozitiv, i cili është përfundimtar dhe pas miratimit të saj do të publikohet në „Gazetën Zyrtare të RMV-së“ dhe në ueb faqen e Agjencisë.

Përktheu: Antoneta Shabani

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Mr. Sasho Stefanovski**

Këshillë juridike: Pjesëmarrësi në Konkurs për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, publikuar në bazë të Vendimit PA1 nr.08-153 datë 8.5.2025 („Gazeta Zyrtare e RMV-së“, nr.96/25 datë 14.5.2025), nëse është i pakënaqur me Vendimin, ka të drejtë në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Vendimit të paraqesë padi në Gjykatën Administrative të RMV-së.